

**REPUBLIKA E SHQIPERSISE**  
**SHOQERIA TREGETARE**  
**"LAYO" SH.P.K.**  
**TIRANE**

**VENDIM NR 12, DATE 27/06/2018**  
**I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE TREGTARE**  
**"LAYO" SH.P.K.**  
**TIRANE**

Ne Tirane, sot ne date 27, muaji Qershor, viti 2018, u mblodh Ortaku i vetem i Shoqerise Tregtare "LAYO" Sh.p.k. Tirane , ne seline e saj mori ne shqyrtimi rendin e dites :

- a) Shqyrtimi i veprimtarise tregtare dhe tregueseve financiare te Shoqerise "LAYO " Sh.p.k. Tirane, per vitin financiar 2017 si dhe ecuria e saj ne te ardhmen;
- b) Zmadhimin e kapitalit themeltar te Shoqerise Tregtare "LAYO " Sh.p.k. Tirane ;

Ortaku i Vetem ,z. Vasil LLAJO, pasi u njoh me rendin e dites

**VEREN SE :**

Shoqeria Tregtare "LAYO " Sh.p.k. Tirane, eshte e rregjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit, date 17.11.2009, me ortak te vetem z. Vasil LLAJO dhe administrator z. Vasil LLAJO.

Gjate shqyrtimit te veprimtarise tregtare dhe tregueseve financiare te shoqerise "LAYO " Sh.p.k. Tirane, Ortaku konstaton se per te patur nje vazhdimesi dhe siguri te veprimtarise, te beje kalimin e fitimeve te pa shperndara gjendje sipas bilancit te mbyllur me 31.12.2017 per zmadhim te kapitalit aksionar te kesaj shoqerie me vleren 60,000,000 Leke dhe diferenca per shumen 4,947,675 Leke per shtim te rezervave ligjore me 3,459,484 leke dhe shtim te rezervave te tjera me 1,488,191 leke, ne baze te Statutit, Aktit te Themelimit dhe Ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" .

Per keto arsye,Ortaku i Vetem i Shoqerise Tregtare "LAYO " Sh.p.k. Tirane, pas shqyrtimit te rendit te dites :

**VENDOSI :**

- Miratimin e llogarive vjetore te Shoqerise Tregtare "LAYO " Sh.p.k. Tirane, per vitin financiar 2017 te mbyllura me date 31.12.2017;
- Kalimin e fitimeve te pa shperndara gjendje sipas bilancit te mbyllur me 31 Dhjetor 2017 per zmadhim te kapitalit aksionar me vleren 60,000,000 Leke dhe diferenca per shumen 4,947,675 Leke ne shtim te rezervave ligjore me 3,459,484 leke dhe shtim te rezervave te tjera me 1,488,191 Leke;
- Caktimin e z. Lavdimir FUSHA, anetar i Insitutit te Eksperteve Kontabel te Regjistruar, me Nr.Licence 97 date 10.01.2001, per vleresimin e zmadhimit te kapitalit aksionar nepermjet fitimeve te pa shperndara;
- Depozitimimin e ketij vendimi prane Qendres Kombetare te Biznesit dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane.

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE TREGETARE**

**"LAYO" SH.P.K TIRANE**

**VASIL LLAJO**



**REPUBLIKA E SHQIPERSISE**  
**SHOQERIA TREGETARE**  
**"LAYO" SH.P.K.**  
**TIRANE**

---

**VENDIM NR 13, DATE 19/07/2018**  
**I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE TREGTARE**  
**"LAYO" SHPK TIRANE**

Në Tirane, sot në datën 19, muaji Korrik, viti 2018, u mbledh Ortaku i Vetëm i Shoqërisë Tregtare "LAYO" SHPK Tirane, në selinë e shoqërisë, për shqyrtimin e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Raportit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar për vlerësimin e fitimeve të pashpërndara për zmadhimin e kapitalit aksionar të Shoqërisë, të datës 18 Korrik 2018 të përgatitur nga z. Lavdimir FUSHA, Ekspert Kontabël i Regjistruar;

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, pasi u njoh me rendin e ditës;

**V Ë R E N S E**

Shoqëria Tregtare "**LAYO**" SHPK Tirane, është regjistruar pranë Qendres Kombetare te Biznesit me date 17.11,2009.

Ortaku i Vetëm i kësaj shoqërie është z. Vasil LLAJO. Kapitali aksionar i kësaj shoqërie është 90,000,000 Lekë. Kështu, z. Vasil LLAJO zotëron 100 % të kapitalit aksionar, i barabartë ky me 100 (njeqind) kuota me vlerën 90,000,000 Lekë, ku secila kuotë ka vlerën prej 900,000 Lekë;

Me Vendimin Nr. 12, datë 27/06/2018 Ortaku i Vetëm i Shoqërisë ka vendosur:

- Miratimin e llogarive vjetore te Shoqerise Tregtare "LAYO " Sh.p.k. Tirane, per vitin financiar 2017 te mbyllura me date 31.12.2017;
- Kalimin e fitimeve te pa shperndara gjendje sipas bilancit te mbyllur me 31 Dhjetor 2017 per zmadhim te kapitalit aksionar me vleren 60,000,000 Leke dhe diferenca per shumen 4,947,675 Leke ne shtim te rezervave ligjore me 3,459,484 leke dhe shtim te rezervave te tjera me 1,488,191 Leke;
- Caktimin e z. Lavdimir FUSHA, anetar i Insitutit te Eksperteve Kontabel te Regjistruar, me Nr.Licence 97 date 10.01.2001, per vleresimin e zmadhimit te kapitalit aksionar nepermjet fitimeve te pa shperndara;
- Depozitimimin e ketij vendimi prane Qendres Kombetare te Biznesit dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane.

Në vështrim të rendit të ditës, Ortaku i Vetëm i kësaj shoqërie, pasi njihet me Raportin e Ekspertit Kontabël të Regjistruar për vlerësimin e fitimeve të pashpërndara për zmadhimin e kapitalit aksionar të Shoqërisë, të datës 18 Korrik 2018, i përgatitur nga Eksperti Kontabël i Regjistruar z. Lavdimir FUSHA, vëren se ky raport është i drejtë, në përputhje me ligjet në fuqi dhe për këto arsye duhet miratuar.



Sipas këtij raporti, zmadhimi i kapitalit aksionar të shoqërisë bëhet nga 90,000,000 (Nentëdhjete milion) Leke ne 150,000,000 (Njëqind e pesëdhjete milion) Leke, e barabartë kjo me 100 (njëqind) kuota (pjesë) kapitali, secila me vlerë nominale prej 1,500,000 (Një milion e pesëqind mijë) Lekë. Pra, vlera nominale e kuotave (pjesëve) të kapitalit aksionar rritet ndersa numri i kuotave (pjesëve) te kapitalit mbetet i pandryshueshëm.

Ky kapital do të zotërohet nga Ortaku i Vetëm në këtë mënyrë:

**z. Vasil LLAJO**, do të jetë përsëri zotërues i 100 % të kuotave të kapitalit aksionar, i cili do të përbëhet nga 100 (njëqind) kuota (pjesë) kapitali nga ku secila kuotë (pjesë) do të ketë vlerën nominale prej 1,500,000 (Një milion e pesëqind mijë) Lekë.

Për këto arsye, Ortaku i Vetëm, pas shqyrtimit të rendit të ditës;

### V E N D O S I

1. Miratimin e Raportit të Ekspertit për vlerësimin e fitimeve të pashperndara për zmadhimin e Kapitalit Aksionar të Shoqërisë të datës 18 Korrik 2018 të përgatitur nga z. Lavdimir FUSHA, Ekspert Kontabel i Regjistruar;
2. Zmadhimin e Kapitalit Aksionar të kesaj shoqërie nga 90,000,000 (Nentëdhjete milion) Leke ne 150,000,000 (Njëqind e pesëdhjete milion) Leke, e barabartë kjo me 100 (njëqind) kuota (pjesë) kapitali;
3. Vlera nominale e kuotave (pjesëve) të kapitalit aksionar rritet ndersa numri i kuotave (pjesëve) te kapitalit mbetet i pandryshueshëm;
4. Vlera nominale e kuotave (pjesëve) të kapitalit aksionar rritet nga 900,000 (Nentëqind mijë) Leke ne 1,500,000 (Një milion e pesëqind mijë) Leke ;
5. **z. Vasil LLAJO**, do të jetë përsëri zotërues i 100 % të kuotave të kapitalit aksionar, i cili do të përbëhet nga 100 (njëqind) kuota (pjesë) kapitali ku secila kuotë (pjesë) do të ketë vlerën nominale prej 1,500,000 (Një milion e pesëqind mijë) Lekë;
6. Depozitimin e këtij vendimi pranë Qendres Kombëtare të Biznesit .

### ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË TREGËTARE "LAYO" SH.P.K TIRANE

VASIL LLAJO

